



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 159, Datë 29.10.2019

MBI

RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SH.A., ME NR. 274, SERIA T15, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 35, DATË 04.03.2015, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE- s Nr.109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 29.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/5 Prot, datë 23.10.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për licencimin e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 529 Prot, datë 02.09.2019, ka paraqitur kërkesën për rinovim licence në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 143, datë 24.09.2019, ka filluar procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., nr. 274, Seria T15, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 35, datë 04.03.2015, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5– vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 35/43, datë 24.09.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria Devoll Hydropower sh.a..
- Me shkresën nr. 588 Prot, datë 29.09.2019, u njoftua shoqëria, lidhur me vendimarrjen e Bordit, si dhe me kërkesën për plotësimin e dokumentacionit të munguar në aplikim.

- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 588/1 Prot, datë 11.10.2019, ka plotësuar dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria “Devoll Hydropwer” sh.a., është mbajtëse e licencës me nr. 274, Seria T15 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të bordit të ERE-s, nr. 35, datë 04.03.2015, me afat 5 vjeçar, afati i së cilës përfundon në datë 04.03.2020.
- Rezulton se shoqëria ka aplikuar 4 muaj para përfundimit të afatit për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, ç’ka është në përputhje me afatin ligjor për paraqitjen e kërkesës për rinovim licence.
- Aplikimi i shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Devoll Hydropwer” sh.a., me nr. 274, Seria T15 të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 35, datë 04.03.2015, në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar, duke filluar që nga data 05.03.2020.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI